



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 209, Datë 07.10.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “DELTA PLAN STUDIO” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1968/1 prot., datë 03.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1968 prot., datë 25.09.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelce, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën nr. 2058 rep., nr. 642 kol., datë 23.05.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, në zonën kadastrale nr. 3038, në fshatin Povelce, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, i nga shoqëria “DELTA PLAN STUDIO” shpk”;
 - Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., Marrëveshjen e lidhjes së re 7330/2 prot., datë 06.09.2023 dhe ka marrë miratimin epikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a. nr.7330/3 prot., datë 06.09.2023;
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 18.12.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaik DELTA SOLAR PARK, 2 MW”. VNM-ja Paraprake e depozituar nga shoqëria është aktualisht e vlefshme (deri më 18.12.2025), por vlerësohet t’i kërkohet asaj të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit dhe nëse po, t’i dokumentojë ato në ERE.
- Po ashtu, referuar përcaktimeve të nenit 9, të Kontratës me Nr. 2058 Rep., nr. 642 Kol., datë 23.05.2024, nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të ridedepozitojë Aneksin A të kësaj kontrate, pasi dokumenti i depozituar nuk është i qartë dhe nuk mund të identifikohen të dhënat e tij, që mund të shërbejnë për përlllogaritjen e afateve përkatëse. Përveç kësaj, shoqëria duhet të depozitojë informacion nëse është pajisur me lejen e ndërtimit apo nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DELTA PLAN STUDIO” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI